

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ - Departamenti i Pergjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari Adem Shabani, me zyrtarin ligjor Burim Haxhidema, në çështjen penale kundër të akuzuarit Sh.A., nga fshati, Komuna Lipjan, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.473-4/16 e dt.21.03.2017 pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prani të përfaqësuesit të akuzës-prokurorit të shtetit Bahri Hyseni të akuzuarit, me dt. 26.04.2017 solli dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari Sh.A., nga fshati, Komuna Lipjan, data e lindjes....., nëtë njejtin vend, nga i ati Xh. e ëma H. e gjinisë R., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka te kryer shkollen e mesme, i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes të mesme ekonomike, punon privat, me numër të letërnjoftimit, mbrohet në liri,

ËSHTË FAJTORË

Sespe me dt.07.04.2016 rreth orës 18:20, në rrugën “ Halim Spahiu “, në drejtim të rrugës “Remzi Hoxha” në Ferizaj ,ka ndodhur një aksident trafiku ku i pandehuri ishte duke drejtuar automjetin e markës “ VW Pasat ”, me ngjyrë hiri, me targa të regjistrimit, në kundërshtim me dispozitat e nenit 64.1 të LSKRR-së,ka marrë veprim pa u siguruar mirë se me këtë veprim rrezikon pjesëmarrësit tjerë ku në atë moment kyçet ku vije motoçikleta Yamaha YP 400 me ngjyrë të gjelbër me targë të regjistrimit të cilën po e drejtonte J.J., i cili po qarkollonte në rrugën me përparësi kalimi ku pos dëmeve materiale lëndime të lehta trupore pëson motoçiklisti Jashar,lëndimet të lehta trupore të përshkruara si në ekspertizen e ekspertit të mjekësisë ligjore të datës 26.02.2017 e të cilat lëndime rezultojnë me pasoja të përkohshme të shëndetit,-

Me të cilën ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga nen.378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të neneve 4, 7, 41, 46, dhe 73 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së

G J Y K O N ME DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarit **Sh.A.**, i shqipton dënimin me gjobë në shumë prej 200 /dyqindë / Eurosh, të cilin dënim me gjobë është i obliguar ta paguan në afat prej dy muajsh, konform nenit 46 par.2 të KPRK-së, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rastë se personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguan dënimin në të holla, sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

I dëmtuari J.J. nga fshati, Komuna Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohen në kontest civil.

I akuzuari obligohet që në emër të shpenzimeve gjyqësore të paguaj shumën prej 60,88 € si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.473-4/16 e dt.21.03.2017, ka ngarkuar të akuzuarin Sh.A., nga fshati, Komuna Lipjan, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar rreth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPK-së me dt.26.04.2017 ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Bahri Hyseni, dhe i akuzuari.

Në shqyrtimin fillestar gjyqtari ka konstatuar se i akuzuari në afatin ligjor me kohë së bashku me ftesën për shqyrtim, ka pranuar edhe një kopje të aktakuzës.

Në fillim të shqyrtimit fillestara i akuzuari është udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të drerjtat e të akuzuarit janë respektuar, e më pas prokurori i shtetit ka lexuar atakuzën ndaj të akuzuarit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i njëjti e ka kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën është akuzuar, të njëjtit i ka dhënë mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet.

Përkritazi me këtë i akuzuari Sh.A. ka theksuar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar në vazhdim ka theksuar se atë diti ishte duke drejtuar automjetin e markës “ VW Pasat ”, prej rrugës Halim Spahiu në drejtim të rrugës “ Rezi Hoxha “,metë arritur te kryqëzimi i rrugës është ndalur tek shenja stpo ku pastaj ka filluar që të kyçet në rrugë për të kaluar në anën e kundërt,papritmas ka ardhur motoçikleta me pjesën e parë të përparmë e ka goditur në anën e djathtë në rrotën e parë, dhe menjëher ka ndalur veturen dhe ka dalur për ti ofruar ndimë ku edhe e njoftë më heret menjëher i ka thirrur policin dhe njoftuar me rastin ku gjendja e tij tani është e mirë dhe raportet me te i kanë të mira ku në fundë ka deklaruar se veprën penale për të cilën akuzohet nuk e ka kryer me dashje por i ka ndodhur siq mund ti ndodh çdo kujt që vozit, është penduar për veprën e kryer dhe i ka propozuar gjykatës që ti shqipton një dënim më të butë.

Gjyqtari në kuptim nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPK-së, është e bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit.

Pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë, mbrojtësit dhe të dëmtuarit

Prokurri i shtetit Bahri Hyseni ka theksuar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit pasi pranimi i fajësisë është bërë konform ligjit.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar se i akuzuari pranimin e fajësisë e ka mbështet në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale në mendimin dhe konstatimin e ekspertit të mjekësisë ligjore të dt.19.03.2017, në ekspertizën e ekspertit të komunikacionit të dt.26.02.2017 si dhe fotografit që gjenden në shkresat e lëndës.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet e veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK së të cilat ndikojnë në llojinë dhe lartësinë e dënimit, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori pranimin e fajësisë nga ana e të njëjtit, pendimin për veprën e kryer, interesimin për gjendjen e të dëmtuarit e për rastin konkret gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe rrezikshmerinë konkrete të kësaj vepre penale, dhe në kuptim të të gjitha këtyre, i shqiptoi dënim me gjobë në shumë prej 200 / dyqindë/ Eurosh , si në dispozitiv duke qenë e bindur se një dënim i tillë është në proporcion dhe raport me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarit dhe me te arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale që i akuzuari të mos kryejë vepra penale si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj vepre penale në shoqëri konform nenit 41 të KPRK-së.

Konformë nenit 463 parag.1 lidhur me par 3.të KPPK-së të dëmtuarin J.J., nga fshati, Komuna Ferizaj, për realizimin e kërkeses pasuroro-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Konformë nenit 450 par.2.6 të KPPK-së obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve gjyqësore në shumën prej 60,88 € si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
P nr.700/2017 me datë 26.04.2017

Zyrtari ligjor
Burim Haxhidema

Gjyqtari
Adem Shabani

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mundë të ushtrohet ankesë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate